



**SICURI
PER
SCELTA**
Muoversi. Con intelligenza

DOVE ANDIAMO?

**TÈ SIGURTÈ PÈR
ZGJEDHJE**

progetto promosso da



con il patrocinio di



Ministero dell'Istruzione e del Merito

Ufficio Scolastico Regionale per il Piemonte
Ufficio VI - Ambito Territoriale di Cuneo

in collaborazione con



TË SIGURTË PËR ZGJEDHJE



1. Një projekt për edukimin rrugor për sigurinë rrugore dhe udhëtim të përballueshëm
2. Situata 1 - Iriqi nuk ndalon.
3. Situata 2 - TEDDI NUK ËSHTË NË ndenjësën përfocuese të makinës
4. Situata 3 – EDHE TË NGASËSH MAKINËN TË LODH
5. Situata 4 - ZAKONE TË MIRA PËR TU PËRHAPUR
6. Pyetësor/QUIZ për të rriturit

NJË PROJEKT I EDUKIMIT PËR SIGURINË RRUGORE DHE UDHËTIMI TË PËRBALLUESHËM

Nga qytetet e mëdha në qytetet e vogla, jeta e përditshme e secilit prej nesh nënvizohet nga udhëtimet që bëjmë, pavarësisht se lëvizim në hapësirën urbane apo në hapësirën jashtëurbane për të arritur në shkollë, kthimit nga puna ose kthimit në shtëpi. Një rutinë e përbërë nga rregulla thelbësore për lëvizjen e sigurt, por edhe nga zakone dhe pakujdesi të vogla që mund të na bëjnë të harrojmë rëndësinë e rregullave.

Për këtë arsye lindi projekti **“TË SIGURTË PËR ZGJEDHJE. Të lëviz. Me inteligjencë”** (**“Sicuri per Scelta. Muoversi. Con intelligenza”**), një nismë kushtuar edukimit për sigurinë rrugore he udhëtimi të përballueshëm e cila synon të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë përdoruesve të rrugës për respektimin e rregullave dhe të promovojë një perceptim korrekt të rrezikut. Me një buxhet prej 300 mijë eurosh, projekti mbështetet nga një rrjet entesh aktive në këtë zonë: **Provincia di Cuneo, Fondazione CRC, Fondazione CR Fossano, Fondazione CR Saluzzo e Fondazione CR Savigliano** me bashkëpunim shkencor të **S.I.P.Si.Vi** (Società Italiana di Psicologia della Sicurezza Viaria) dhe nën patronazhin e **Ufficio Scolastico Regionale**.

Për tre vjet rresht, nga viti 2024 deri në vitin 2026, **“Sicuri per Scelta” (TË SIGURTË PËR ZGJEDHJE)** do të ndalet në shkollat e të gjitha niveleve në provincë, duke sjellë mesazhin e sigurisë rrugore drejtpërsëdrejti tek studentët/nxënësit, e cila synon përhapjen e nocioneve duke ndërthurur elemente teorike, momente reflektimi dhe lojëra për të luajtur në klasë dhe me familjet.



Materiali informues synon të promovojë një aksion të fortë kulturor kushtuar rritjes së perceptimit të rrezikut rrugor, duke kontribuar në reduktimin e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së aksidenteve rrugore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sjelljet e rrezikshme rrugore dhe orientimit drejt zgjedhjes së mënyrave të lëvizjes ekologjike.

Botimi i titulluar **“Dove andiamo?” “Ku do shkojmë?”** i kushtohet nxënësve të moshës 9 dhe 10 vjeç dhe do t'u shpërndahet klasave të katërta të shkollave publike dhe atyre private/jopublike pjesëmarrëse në projekt.

Objektivi i identifikuar është **pasagjeri i transportuar**, një rol që me të vërtetë përfshin të gjithë shfrytëzuesit e rrugës, të çdo moshe: djemtë dhe vajzat që ndjekin vitin e katërt të shkollës fillore mund të bëhen në këtë mënyrë promovues të vërtetë të sjelljes së virtytshme rrugore jo vetëm për veten e tyre, por edhe për anëtarët e familjes së tyre dhe të rriturit.

Nëpërmjet tregimeve të ilustruara (fumetti) dhe të shpjeguara nga një asistent i posaçëm, në këto faqe do të mund të zbuloni sjelljet që duhen ndjekur kur udhëtoni si pasagjer dhe ato që nuk duhen harruar kurrë kur të jeni vozitës/shoferë.

FËMIJA PASAGJERI I TRANSPORTUAR

Gianni, fëmijë protagonist i mini-librit, tekta eksperimenton rolin e pasagjerit të transportuar nga një i rritur, ka mundësinë të përjetojë eksperiencën të rëndësishme personale për marrëdhënien e tij me rrezikun rrugor.

Katër situata për të reflektuar mbi sigurinë e pasagjerit të transportuar dhe një skedë loje për të vëzhguar kompleksitetin e mjedisit urban.

Mini-libri, i destinuar për fëmijët e moshës 9-vjeçare, ilustron një kurs edukativ mbi perceptimin e rrezikut të rrugës dhe ofron pika reflektimi për të rriturit duke propozuar përvetësimin e një sjelljeje shembullore rrugore.



Situata 1 - IRIQI NUK NDALON

Gianni është një djalë 9-vjeçar, jeton në fshat dhe çdo të enjte, pasdite vonë, shkon në një qendër sportive të qytetit për tu stërvitur në futboll. Është muaji Nëntor, mot me shi, babai po pret Gianni-n para palestrës për ta përcjellur në shtëpi.

Kur futet në makinë, fëmija ndihet i zënë ngushtë nga xhaketa e tij dhe nuk dëshiron të vendosë rripin e sigurimit. Gianni shpreh një paragjykim tipik: a është vërtetë kaq i dobishëm rripi i sigurimit edhe në udhëtime të shkurtra rutinë? Por ja që babai i tij i tërheq vëmendjen dhe Gianni, i bindur, mbërthen rripin. Babai i di rregullat e kodit rrugor: që kur motori është në punë, duhet të jesh gjithmonë i lidhur. Dhe në çast ndodh një ngjarje e papritur: një iriq kalon rrugën, duke e detyruar babanë të frenojë papritur. Shoferi dhe pasagjeri janë të frikësuar, por nuk janë të lënduar, sepse secili mbrohej nga rripi i sigurimit.



Neni 172 i Kodit rrugor që rregullon transportin e fëmijëve në automjete.

Nëse fëmija 9-vjeçar është më pak se 150 cm i gjatë, ai duhet të fiksohet në ndenjësë me një sistem të aprovuar për mbajtjen e fëmijëve (ulëse ose ndenjësë përforcuese), të përshtatshme për peshën e tij.

Mbështetësja për fëmijë është e detyrueshme deri në një gjatësi prej 125 cm.

Kur ai arrin një lartësi prej 150 cm, fëmija mund të udhëtojë i sigurt i ulur direkt në ndenjësë dhe i shtrënguar lart me rripin e sigurimit. **GJITHMONË**, në çdo situatë kur automjeti është në lëvizje.

Në Bashkimin Evropian, ulëset/ndenjëset përforcuese dhe të ngritura të makinave rregullohen nga dy rregullore të ndryshme.

Është e rëndësishme të kontrolloni etiketën e vendosur në ndenjëset përforcuese: ajo tregon kodin e sigurisë për fëmijët.

INFORMOHUNI DHE QËNDRONI TË INFORMUAR!



Një "sistem mbajtësës" është një pajisje sigurie për fëmijë, që anulon ose kufizon dëmtimet në rast të një përplasjeje ose goditjeje.

Nga 1 shtatori 2024 në Bashkimin Evropian, sistemet e ndalimit/mbajtjes për fëmijët që udhëtojnë me makinë janë të rregulluara nga rregulloret e reja të homologimit ECE R129 i-Size, të cilat bazohen në prova më teknologjike dhe të plota të sigurisë. Sistemet e ndenjësëve tani klasifikohen bazuar në lartësinë e fëmijës, dhe jo më në peshën si më parë. Pjesa e mbështetëses për fëmijët është e detyrueshme deri në një lartësi prej 125 cm, për një mbrojtje më të mirë në rast të një përplasjeje anësore. Për më tepër, mekanizmi ISOFIX për fiksimin e ulëses/ndenjësës së fëmijës njihet si më i sigurti dhe më efektiv për të garantuar mbajtjen maksimale në rast të një aksidenti. Është e rëndësishme të kontrolloni etiketën portokalli të vendosur në ndenjësën e fëmijës, ku janë gjithmonë të shënuara të dhëna të rëndësishme si lloji i ndenjësës, masat e madhësisë së fëmijës për të cilin mund të përdoret dhe rregullorja e çertifikuar.



Situata 2 - TEDDI NUK ËSHTË NË NDENJËSEN PËRFOCUESE TË MAKINËS

Luisa është krenare që ka kaluar testin e shoferit: më në fund mund të përdorë makinën e nënës së saj! Sot Luisa shoqëron Gianni-n dhe Alice-n në shtëpinë e gjyshërve të saj që jetojnë rreth 30 km larg: Është një ditë e veçantë për fëmijët, jo të gjithë kanë një motër me leje drejtimi! Gianni ulet në ndenjës-en përforcuese në sediljen e pasme, Alice po mban Tedin në krahë; Teksa flet në celular, Luisa ndez motorin dhe nisat.

Alice e lë arushin e saj prej pellushi të rrëshqasë në dyshemenë e makinës; Gianni nuk heziton të zërthej rripin e sigurimit ndërsa makina është ndalur për momentin në semafor dhe nuk mund të jetë nën kontrollin e një të rrituri.

Në momentin që semafori ndizet në dritën jeshile, Luisa nisat me shpejtësi dhe Gianni, jo i lidhur duke synuar të marrë arushin prej pellushi, godet faqen e tij të djathtë në ngritësin e sediljes dhe ndjen një dhimbje të fortë.



Nga kjo përvojë Gianni fillon të përvetësojë një vetëdije të specifike: që në moshë të re mund të mësoni të jeni të matur dhe të përgjegjshëm kundrejtë një sjellje të sigurtë.

Neni 173 i Kodit Rrugor ndalon përdorimin e smartphone, kompjuterave portal, tablete dhe pajisjeve të ngjashme që kërkojnë përdorimin e duarve. Shoferi mund të përdorë një sistem me altoparlant (p.sh. bluetooth me komanda zanore) ose kufje me kusht që të mos pengojnë aftësinë dëgjimore (p.sh. kufje në një vesh).

Sipas ekspertëve, përdorimi i celularit/smartphone gjatë drejtimit të makinës rrit mundësinë e një aksidenti 4 herë më shumë duke krahasuar me mospërdorimin e tij sepse nevojiten më

shumë sekonda për të:

perceptuar rrezikun → reaguat për të shmangur atë → ndaluar automjetin
koha e reagimit / distanca e reagimit / distanca e frenimit

INFORMOHUNI DHE QËNDRONI TË INFORMUAR!



Situata 3 - EDHE TË NGASËSH MAKINËN TË LODH

Mamaja ka organizuar një vizitë tek miqtë që jetojnë rreth 700 km larg, duke filluar nga dita e enjte pasdite vonë dhe kthimin të dielën në mbrëmje, duke zgjedhur për të udhëtuar makinën e madhe e cila është më e përshtatshme për rrugë të gjata. Dhe tani vjen koha për t'u përgatitur për udhëtimin e kthimit në Piemonte.

Tregohet nëpërmjet tregimit të ilustruar (*fumetti*) që përshkruan udhëtimin e kthimit për në shtëpi. Pas 3 ditëve të kaluara me miqtë, ata sjellin në shtëpi jo vetëm kujtimet e momenteve të lumtura; por edhe, valixhe, çanta shpine, çanta dhe pako që janë brenda në makinë:

për një udhëtim të sigurt është e rëndësishme që të shpërndani mirë ngarkesën në makinë

Edhe qenushi e ka vendin e vet: Gianni shpjegon që edhe **qeni Leo duhet të udhëtojë në bagazh, në transportuesin/kafazin përkatës.**

Errësohet, zhurma e motorit dhe lëkundjet e bëjnë më të lehtë gjumin e Gianni-t dhe Alice-s, ndërsa nëna e tyre drejton me kujdes makinën por lodhja e grumbulluar gjatë ditës dhe orët e pakta të gjumit gjatë 3 ditëve të fundit e bëjnë gjithnjë e më të vështirë që të qëndrojnë zgjuar.

Më në fund, ja një servis autogrill... është koha për pushim!

Si transportohet një kafshë në makinë?

Neni 169 i Kodit Rrugor ju lejon të transportoni një kafshë shtëpiake në makinë, me kusht që të mos paraqesë pengesë ose rrezik për drejtimin e automjetit, është e nevojshme ti mbani ato në një kafaz ose mbajtëse të posaçme, ose në pjesën e pasme/bagazhin e automjetit të ndarë në mënyrë specifike nga një rrjetë ose ndarëse të ngjashme.

Në fakt, sjellja e kafshëve nuk mund të parashikohet: edhe nëse e njihni shumë mirë qenin ose macen e juaj, ato mund të frikësohen nga një ngjarje e papritur dhe, nëse lihet e lirë të lëvizë brenda automjetit, do të shqetësonte drejtuesin e saj dhe do të përbënte një rrezik shumë të lartë.

Cilat janë detyrimet e një shoferi?

Neni 141 i Kodit Rrugor thekson faktin se drejtuesi i mjetit nuk duhet të rrezikojë veten e tij dhe të tjerët.

Ky Nen imponon që drejtuesi i çdo automjeti të:

- rregullojë shpejtësinë, duke respektuar kufirin e shpejtësisë por gjithashtu duke marrë pa rasysh kushtet e rrugës, trafikun, gjendjen e automjetit dhe çdo rrethanë tjetër (motin, kushtet fizike, etj.), në mënyrë që të mos përbëjë një rrezik për sigurinë e njerëzve dhe të sendeve;
- ruajë gjithmonë kontrollin e mjetit, veçanërisht kur duhet ta ndalojë me shpejtësi brenda kufijve të fushës së tij të shikueshmërisë dhe për çdo pengesë të parashikueshme.

E ashtuquajtura lodhja e shoferit "driver fatigue".

Përgjumja gjatë drejtimit të automjetit është një nga shkaqet kryesore të aksidenteve të rënda në autostradë (1 aksident në 5) sepse redukton ndjeshëm aftësinë për të reaguar.

Gjatë përgjumes, shoferi humbet ndërgjegjen për rrezikun e afërt që i kanoset.

Shpesh mendojmë se mund t'i rezistojmë gjumit që vjen, por gjumi më pak se 5 orë në mënyrë të vazhdueshme rrit 4.5 herë mundësinë për t'u përgjumur gjatë vozitjes së automjetit.

Masa më e mirë përpara se të nisemi, është një planifikim i mirë i udhëtimin.



Gjatë udhëtimin, shoferi në rast lodhjeje, ekspertët shpjegojnë se ekziston vetëm një kurë, ndaloni (pit stop) në një vend të sigurt për një "power nap": është një sy gjumë i shkurtër "energjik", zgjat rreth 20 minuta, pastaj disa ushtrime për të shtrirë krahët dhe këmbët... për të qenë gati për tu nisur përsëri në udhëtim.

INFORMOHUNI DHE QËNDRONI TË INFORMUAR!





Situata 4 - ZAKONE TË MIRA PËR TU PËRHAPUR

Me ardhjen e verës është koha për pushime. Të gatshëm për t'u nisur për një udhëtim të ri, familjarët diskutojnë mbi rregullat e sigurisë rrugore për të kuptuar përmbajtjen e tyre dhe për t'i përvetësuar ato në sjelljen e tyre.

Në këtë situatë që paraqitet pyetjet e iriqit zëvendësohen nga dialogu familjar dhe vullneti për të bërë ndryshime në sjelljen personale.

Mamaja përgatitet të drejtojë automjetin fuoristradë dhe të fikë celularin para se të hipë në automjet. Gianni mban mend se si funksionojnë sediljet dhe ndenjëset përforcuese, është e rëndësishme të krahasoni gjatësinë tuaj dhe peshën me shpjegimet në etiketat e sistemit të mbrojtjes.

Në cilat automjete mund të udhëtojë i sigurt një fëmijë 9-vjeçar?

Rregullorja dallon pajisjet dhe veprimet e sigurisë të bazuar në moshën e fëmijëve

Një fëmijë nuk mund të transportohet me (monopattino) skuter elektrik; në motorra pa vend për pasagjerin, automjete që përdoren për punë (furgona, kamionë), mjete bujqësore (traktorë).

Në autobusin e shkollës duhet të lidhë rripin e sigurimit, nëse mjetet janë të pajisur.

Në një taksi mund të udhëtoj vetëm në sediljen e pasme nëse shoqërohet nga një person 16 vjeç e lart.

Në makinë mund të udhëtojë i ulur direkt në sedilje nëse ka arritur një lartësi prej 150 cm; ndryshe duhet të përdorë ndenjësen e duhur, gjithmonë i lidhur me rripin e sigurisë në çdo situatë lëvizjeje.

Në rast aksidenti rrugor: ndenjësja përforcuese duhet të ndërrohet.

INFORMOHUNI DHE QËNDRONI TË INFORMUAR!

SA E NJIHNI SIGURINË RRUGORE?

Ta zbulojmë së bashku!

Fëmija është i ftuar të zgjedhë një të rritur për ti bërë pyetjet në këtë faqe.

Qëllimi i kuizeve nuk është vlerësues, përkundrazi synojnë të aktivizojnë një konfrontim/dialog në familje për të përvetësuar disa nocione themelore rreth sigurisë rrugore.

I rrituri duhet të përgjigjet sinqerisht, pa kërkuar përgjigje në celularin e tij.

Duke e sjellë pyetësin me përgjigjet e plotësuara përsëri në shkollë, fëmija do të shohë me kënaqësi angazhimin e tij personal.

1) Ripat e sigurimit:

- a. janë të detyrueshme vetëm në autostradë _____ V F
- b. nuk janë të detyrueshme në sediljet e pasme _____ V F
- c. janë të detyrueshme vetëm për fëmijë nën 18 vjeç _____ V F
- d. nëse ngisni ngadalë, nuk keni nevojë për to _____ V F
- e. nëse janë lidhur siç duhet, mund t'ju shpëtojnë jetën _____ V F

2) Një aksident rrugor ndodh për shkak të.....

- a. fatalitet/fatkeqësi _____ V F
- b. nënvlerësim të rrezikut rrugor _____ V F
- c. nxitim/shpërqëndrim _____ V F
- d. kontrole të pamjaftueshme _____ V F

3) Mundësia për të ndodhur një aksident është më e lartë:

- a. në autostradë _____ V F
- b. në rrugë ekstraurbane (jashtë qytetit) _____ V F
- c. në qytet _____ V F
- d. pak a shumë është e njëjtë në të gjitha rrugët _____ V F

4) Në rast shiu, bore ose mjegulle:

- a. është më mirë të ulni shpejtësinë _____ V F
- b. është e nevojshme vetëkontrolli nga ankthi/frika _____ V F
- c. mund të vozitësh si në kushte normale _____ V F
- d. nuk ka rreziqe të veçanta _____ V F
- e. hapësira e vetë reagimit mund të jetë më e gjatë _____ V F

5) Koha e reagimit:

- a. varet nga shpejtësia që po udhëtoni _____ V F
- b. zgjat rreth 1 sekondë _____ V F
- c. varet nga gjendja/kushtet e shoferit _____ V F
- d. nga koha që kalon nga momenti kur perceptohet një rrezik deri në momentin kur filloni të ndërmerrni veprime për ta shmangur atë _____ V F
- e. bëhet më i ngadalshëm nëse bëni dy veprime në të njëjtën kohë _____ V F

6) Hapësira e reagimit:

- a. varet nga shpejtësia që po udhëtoni _____ V F
- b. matet në metra për sekondë (m/s) _____ V F
- c. varet nga kushtet e motit (shiu, bora, etj.) _____ V F
- d. është distanca e përshkuar gjatë kohës së reagimit _____ V F

7) Ti biesh një numri telefoni në celular gjatë vozitjes rrit mundësinë e një aksidenti duke:

- a. dy herë _____ V F
- b. katër herë _____ V F
- c. dymbëdhjetë herë _____ V F
- d. nuk rrit mundësitë e një aksidenti _____ V F